

Elbasan 17.06.2015

### **Deklarate e Unionit te Gazetarëve - Dega Elbasan**

Unioni i Gazetarëve të Qarkut të Elbasanit, i mbledhur sot ( 17/06/2015) ndërmjet problemeve të tjera diskutoi edhe rreth transmetimit të një videoje në rrjetet sociale dhe mediat, pa autoresi raportuesi. Filmimi në fjalë është realizuar kohë më parë dhe ka të bëjë me një bisedë informale e cila është transmetuar fragmentalisht dhe jashtë kontekstit. Unioni i Gazetarëve të Elbasanit, bën me dije se në asnjë rast nuk kemi pasur denoncime apo ankesa nga kolege për ekzistencën e një video- rregjistrimi ku të shantazhohen mediat apo gazetarët. Ne shprehim opinionin se publikimi i një pasazhi të tillë ku shfaqet vetëm një protagonist elektoral, është përdorur në kohë të vonuar dhe ndoshta për qëllime politike.

Unioni i Gazetarëve të Qarkut të Elbasanit deklaroi se : problemet tona në marrëdhëniet me institucionet apo me individë me pushtet, i kemi zgjidhur dhe perballuar me reagim të perhershëm solidar dhe me profesionalizem. Unioni i Gazetarëve të Elbasanit nuk është pale me asnjë subjekt politik dhe nuk do të jetë edhe në të ardhmen. Sqarojmë se sa i përket një certifikate të dhënë për ish-kryetarin e Bashkisë së qytetit në vitin 2012, kjo ka të bëjë me një veprimtari të fundvitit të Degës sonë, në të cilën sipas traditës disa vjetë në vlerësojmë dhe shprehim mirënjohje për institucione apo personalitete lokale dhe më tej, Dega e Unionit ka pasur si parim vlerësimin e partneritetit institucional dhe punën për mbrojtjen e lirise së medias në vend.

Unioni i Gazetarëve Elbasan